



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 124, Datë 11.05.2021

MBI

RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 14, DATË 20.01.2021, MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY- AL” SH.P.K., NR 115/310, SERIA F11/FK15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 11.05.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 68/1 Prot., datë 04.05.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me plotësimin e kushteve të vendimit nr. 14, datë 20.01.2021, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- ERE me vendimin nr. 14, datë 20.01.2021, vendosi:
 1. “Të rinovojë licencën e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, datë 02.02.2011, për një afat 5 vjeçar”, duke filluar nga data 04.02.2021, me kusht që përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar të depozitohet në ERE:
 - a. Vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë.
 - b. Dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë “Energy Supply– AL” sh.p.k. apo strukturën e financimit.
 - c. Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi.

- d. Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve.
2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE pasi të analizohet dokumentacioni i përcjellë nga shoqëria “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k. sipas kërkesave të pikës 1, të këtij vendimi.
- Në vijim të sa më sipër, ERE iu drejtua shoqërisë “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k. me shkresën nr. 128 prot., datë 26.01.2021, duke i njoftuar vendimet përkatëse.
 - Shoqëria “Energy Supply -AL” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/5 prot., datë 29.01.2021, ka përcjellë argumenta dhe një pjesë të dokumentacionit në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimeve të licencimit. Duke qenë se u konstatua ende mungesë, ERE iu drejtua sërish shoqërisë “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k. me shkresën nr. 299, datë 11.02.2021, ku i ka kërkuar sërish plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me kushtet e vendimeve të rinovimit të licencave. Shoqëria vijoi plotësimin kryesisht të dokumentave në përmbushje të kushteve të vendimeve të rinovimit të licencave të saj me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 299/1 prot., datë 16.02.2021. Duke qenë se nevojitej ende dokumentacion, ERE me shkresën nr. 299/2 prot., datë 25.02.2021, iu drejtua sërish shoqërisë “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k.. Kjo e fundit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 299/4 prot., datë 11.03.2021, përcolli një pjesë të dokumentacionit të munguar dhe si e tillë ERE iu drejtua sërish me shkresën nr. 299/5, datë 29.03.2021, duke përsëritur kërkesën e saj. Në përgjigje të sa kërkuar shoqëria “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k. me shkresën nr. 299/6, datë 21.04.2021, përcolli dokumentacionin e munguar.
 - Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë në ERE nga shoqëria “Energy Supply -AL” sh.p.k., në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimeve 13/2021 dhe 14/2021, rezulton si më poshtë:
 - Kushti i vendosur në pikën 1, gërma “a. Vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë”, të vendimit nr. 14/2021, **është plotësuar nga shoqëria “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k..**
 - Kushti i vendosur në pikën 1, gërma “b. Dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë “Energy Supply– AL”, apo strukturën e financimit”, të vendimit nr. 14/2021, **është plotësuar nga shoqëria “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k..**
 - Kushti i vendosur në pikën 1, gërma “c. Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi”, të vendimit nr. 14./2021, **është plotësuar nga shoqëria “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k..**
 - Kushti i vendosur në pikën 1, gërma “d. Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve”, të vendimit nr. 14/2021, **është plotësuar nga shoqëria “ENERGY SUPPLY -AL” sh.p.k..**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit të ERE nr. 14, datë 20.01.2021, si vijon:

Të rinovojë licencën e shoqërisë “Energy Supply –AL” sh.p.k., me nr. 115/310, Seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.5, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2021.

2. Gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, të pikës 1 dhe pika 2, e vendimit nr. 14/2021 shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI